

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME PËR GRANTE

Nr. 042023

TITULLI I PROJEKTIT:

“SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE PËR ZHVILLIMIN NDËRKUFITAR SOCIO-EKONOMIK TË ZONAVE TË MBROJTURA NË MAQEDONINË VERIORE DHE SHQIPËRI (KORAB-KORITNIK, SHARR DHE ALPET SHQIPTARE)”

Dorëzimi i projekt propozimeve nga Organizatat Joqeveritare, fermerë/individë, biznese të vogla dhe të mesme të përfshira në aktivitetet e menaxhimit të burimeve natyrore në kufijtë administrative qarqeve Diber, Kukes dhe Shkoder, për aktivitetet brenda territorit të Alpeve Shqiptare dhe zonën e parkut natyror “Korab Koritnik”, në kuadër të projektit PONT me qëllim përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar social-ekonomik të zonave të mbrojtura.

Vështrim i përgjithshëm

CNVP është një organizatë hollandeze që operon në Ballkan. Misioni ynë është të promovojmë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ofrojmë mbështetje për komunitetet dhe qeverisjen lokale në krijimin e një jete në harmoni me natyrën. Nëpërmjet projekteve të ndryshme, ne synojmë të kontribuojmë për një Europë më të mirë ne pjesen Juglindore duke u fokusuar në gjashtë fusha kryesore:

1. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
2. Ndryshimi i klimës
3. Zhvillimi rural
4. Energjia e rinovueshme
5. Mobilizimi i komunitetit
6. Aderimi evropian

CNVP, përmes degëve të saj në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, po zbaton një projekt trevjeçar “ **Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar socio-ekonomik të zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut** (Korab-Koritnik, Sharr dhe Alpet Shqiptare)”, financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust (PONT).

Në zbatimin e këtij granti, CNVP bazohet në përvojën e saj në Prespë të mbështetur nga PONT, si dhe në punën e saj të gjerë në vendet e Ballkanit gjatë shumë viteve me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Projekti synon të përmirësojë kushtet socio-ekonomike të komuniteteve lokale, duke kontribuar në ruajtjen e natyrës. Ai fokusohet veçanërisht në përdorimin e qëndrueshëm të produkteve pyjore jo-drunore (PPJD) dhe turizmin e bazuar në natyrë, duke përdorur një qasje pjesëmarrëse, ndërkufitare dhe ndërsektoriale.

Për më tepër, ne do të zbatojmë një program të vogël grantesh për OJQ-të lokale dhe shoqatat e përdorimit të burimeve natyrore, fermeret dhe bizneset e vogla dhe të mesme për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja në turizmin e bazuar në natyrë dhe menaxhimin e PPJD në kontekstin ndërkufitar.

Projekti ka tre objektiva kryesore:

1. Përdorimi i qëndrueshëm i PPJD në zonat e mbrojtura të Sharrit, Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
2. Turizmi i bazuar në natyrë në zonat e mbrojtura të Sharrit, Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
3. Zhvillimi i një mekanizmi qeverisës në Sharr , Korab-Koritnik dhe Alpet Shqiptare për të mundësuar turizmin e bazuar në natyrë dhe shfrytëzimin e burimeve të tjera natyrore të qëndrueshme në këto Zona të Mbrojtura:



Grantet janë të destinuar kryesisht për OJQ-të e kualifikuara me një prani lokale me fokus në Rajonin e Kukësit, Dibër dhe Shkodër dhe me mision dhe strategji të fokusuar në ruajtjen e natyrës si dhe për fermerët dhe bizneset e vogla dhe të mesme në këto rajone. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përpjekjet për ruajtjen, zhvillimin e shoqërive dhe komuniteteve lokale dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Thirrjet e hapura për granteve do të reklamohen në faqen e internetit të CNVP dhe rrjetet sociale të organizatës.

Fusha e thirrjes

Kjo Thirrje për Projekt Propozime për Grante është e hapur për:

- OJQ, aktive në territorin administrativ të bashkisë Dibër, Kukës, Tropojë, Malësi e Madhe dhe Shkodër me mision mbrojtjen e mjedisit, fuqizimin e organizatave lokale, ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në Zonat e Mbrojtura.
- Fermerët/individë që jetojnë brenda territorit të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe brenda territorit të parkut natyror “Korab Koritnik”
- Bizneset e vogla dhe të mesme që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe brenda territorit të parkut natyror “Korab -Koritnik”

Objekti tematik i kësaj Thirrje përcaktohet nga **objektivat e mëposhtëm** :

1. Përdorimi i qëndrueshëm i PPJD në zonat e mbrojtura të Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
2. Turizmi i bazuar në natyrë në zonat e mbrojtura të Korab-Koritnik dhe Alpeve Shqiptare, duke kontribuar si në ruajtjen e natyrës ashtu edhe në zhvillimin e komunitetit lokal në këto Zona të Mbrojtura.
3. Zhvillimi i një mekanizmi qeverisës në Korab-Koritnik dhe Alpet Shqiptare për të mundësuar turizmin e bazuar në natyrë dhe shfrytëzimin e burimeve të tjera natyrore të qëndrueshme në këto Zona të Mbrojtura:

Aktivitetet kryesore do të fokusohen në : 1)komponentët prioritarë të biodiversitetit që përfitojnë nga produktet dhe shërbimet e reja për turizmin e bazuar në natyrë; 2) Rritjen e të ardhurave për aktorët lokal nga aplikimi i praktikave dhe sistemeve të reja në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ; 3) Mekanizmat qeveritare për Zonat e mbrojtura mundësojnë menaxhim efektiv, të barabartë dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Shtirja gjeografike e kësaj thirrje është e kufizuar në Parkun kombëtar “Alpet Shqiptare” dhe në parkun natyror “Korab Koritnik”.

Kualifikimi i aplikantëve

Projekt propozimet në kuadër të kësaj Thirrjeje do të dorëzohen nga OJQ lokale, fermerë ose individë, biznese të vogla dhe të mesme lokale të fokusuar në propozime që kanë ndikim në qëndrueshmërinë ekologjike si dhe aplikimin e parimeve dhe praktikave sipas modeleve të “bizneseve të gjelbra”, që plotësojnë kriteret dhe janë aktive në **territorin e PK “Alpet Shqiptare” dhe në zonën parkut natyror “Korab Koritnik”**. Për qëllimet e kësaj Thirrje, aplikanti i kualifikuar duhet të ketë statusin e duhur ligjor sipas ligjit shqiptar, i regjistruar në tatim-taksa, të ketë numrin e fermerit (për fermeret), të mos kenë detyrime fiskale të pashlyera dhe të kenë një llogari bankare aktive. Misioni i deklaruar i OJQ-ve aplikuese duhet të përfshijë mbrojtjen dhe/ose ruajtjen e natyrës, ndërgjegjësimin e komunitetit në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Ju lutemi vini re se aplikantët që aktualisht po zbatojnë projekte me financime nga PONT nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje.

Aplikantët në të cilët personeli i Zonave të Mbrojtura është i përfshirë si anëtar i bordit dhe menaxhimit ose veprojnë si staf/ekspertë të bizneseve/fermereve, OJQ-ve nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Aktivitetet e pranueshme

Skema e nën-granteve mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për organizatat lokale për përmirësimin e kapaciteteve teknike (seminare, vizita studimore ndërkufitare) duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor, nga perspektiva e Turizmit të Bazuar në Natyrë (TBN), Prodhimeve Pyjore jo Drunore (PPJD) dhe biodiversitetit.
- Ndërgjegjësim dhe trajnime të komuniteteve lokale për grumbullimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, Bimeve Mjekësore Aromatike e Tanifere (BMET) në zonat e mbrojtura (praktikat dhe rregulloret e mbledhjes së qëndrueshme, mjetet alternative të jetesës, ruajtja, efektet ndërkufitare dhe bashkëpunimi me autoritetet)
- Përmirësimi i mekanizmave për përdorimin e qëndrueshëm të PPJD-ve, BMET-ve (aftësitë sipërmarrëse, promovimi, zhvillimi i produkteve pyjore jodrunore, bimëve mjekësore dhe aromatike, dhe turizmit të bazuar në natyrë).
- Blerja i pajisjeve për përmirësimin e objekteve për përpunimin dhe tharjen e produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike (Llojet e pajisjeve: mbledhja dhe ruajtja, përgatitja për treg, pastrimi, larja, tharja, klasifikimi, kalibrimi, heqja e frutave të dëmtuara, pajisjet për prerje, bluarje dhe pajisje të tjera për përgatitje para përpunimit, pajisje për konservim, tharje, ngrirje, pajisje mbushëse, ambalazhimi dhe shënimi/etiketimi, pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme kontrolli me mundësi për gjurmimin e produktit, ruajtjes dhe shpërndarjes së tij).
- Çertifikimi për grumbulluesit dhe kultivuesit organikë të bimëve mjekësore
- Përmirësimi i kapaciteteve për kultivimin organik të produkteve pyjore jodrunore dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave. (Ofrimi i trajnimeve, burimeve dhe mbështetjes për komunitetet lokale për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë praktika kultivimi të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, për të krijuar lidhje me tregun, dhe për të promovuar praktika të qëndrueshme) si dhe krijimi i fidanishteve lokale për prodhimin e fidanave të certifikuar të bimëve mjekësore, frutave të pyllit, etj.
- Mbeshtetje e konsoliduesve lokalë për BMET-të dhe produktet e tjera pyjore jodrunore për të garantuar tregti të drejtë dhe praktika të qëndrueshme të mbledhjes (partneritetet me komunitetet lokale, promovimi i praktikave të qëndrueshme të mbledhjes, ofrimi i trajnimeve dhe burimeve dhe sigurimi i çmimeve të drejta).
- Pajisje për përpunimin dhe prodhimin e ushqimit tradicional nga ofruesit e shërbimeve turistike të bazuara në natyrë (pajisje për përpunim: prerës, bluarës dhe dehidratues, pajisje për prodhim: furra, soba dhe enë, ndricimi me panele diellore, pajisje për turizmin e bazuar në natyrë, si p.sh. pajisje për kamping, pajisje për vëzhgim të kafshëve të egra etj.).
- Promovimi i tureve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonomitë lokale dhe për të ruajtur traditat kulturore. Mund të mbështeten edhe aktivitetet ndërkufitare për promovim.
- Rregullimi/përmirësimi i kapaciteteve dhe objekteve akomoduese private pranë ofruesve të shërbimeve turistike/produkteve të bazuara në natyrë (për rregullimin, pajisjen apo rinovimin e objektit sipas traditës në vend).
- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të bazuara në natyrë në zonat e mbrojtura.
- Nxitja e aktiviteteve të bletarisë në keto zona (rrethim i parqeve dhe ndricimi me fotovoltaike), që do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin ekonomik.
- Evidentimi dhe përgatitja e materialeve informuese dhe udhëzuese që do të pasqyrojnë vendndodhjen e shtigjeve, monumenteve të natyrës dhe vendeve të tjera për tu vizituar.

Aplikimi për një Grant

Aplikantët duhet të dorëzojnë projekt propozimin sipas formateve dhe manualit bashkangjitur kësaj shpallje.

Modeli i aplikimit dhe kërkesat e detajuara gjenden në faqen e internetit të CNVP: <http://cnvp-eu.org>

Shuma **minimale** e grantit është **1.000 euro**, ndërsa shuma **maksimale** është **20.000 euro**

Afati kohor i zbatimit të grantit është **12 muaj**, nga data **24 Nëntor 2023 deri më 23 Nëntor 2024**.

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë projekt propozimet e tyre në mënyrë elektronike ne adresen isuf.omuri@cnvp-eu.org jo më vonë se data **8 nëntor 2023** në orën 24:00.

Për të aplikuar për një grant sipas kësaj Thirrje, ju lutemi plotësoni **dokumentat e aplikimit** të disponueshëm **[këtu](#)**

Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për grante, aplikantët e mundshëm mund të bëjnë pyetje në lidhje me dokumentacionin që duhet të dorëzohet. Ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja deri më **6 nëntor 2023 deri në orën 16:00**.

Të gjitha pyetjet nga aplikantët mund të dërgohen në adresën e e-mailit isuf.omuri@cnvp-eu.org

Afati kohor

Afati kohor	Data
Shpallja e Thirrjes	5 tetor 2023
Sesionet informuese	9-26 tetor 2023
Afati i fundit për pyetje dhe kërkesa për sqarime	6 nëntor 2023
Afati i fundit për aplikim	8 nëntor 2023
Kontrolli administrativ, kryerja e procedurës së vlerësimit	15 nëntor 2023
Njoftimi për aplikimet e suksesshme	16 nëntor 2023
Procesi i negociatave	21 nëntor 2023
Kontratat, data e fillimit të projektit	23 nëntor 2023

Procesi i rishikimit dhe hapat e mëtejshëm

Procesi i shqyrtimit të projekt propozimit do të zgjasë afërsisht 7 ditë nga data e afatit. Një komision i posaçëm vlerësues do të zgjedhë projekt propozimet më të mira që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përshkuara më sipër. Aplikanti/ët fitues do të marrin një përgjigje që përshkruan hapat e mëtejshëm për projekt propozimin e tyre.